

VENDIM
Nr. 141/2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 100/2017 “PËR
CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21/1 dhe 55, pikat 2 dhe 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

1. Deputetja Ardiana Jaku caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Integrimin Europian në vend të deputetes Eglantina Gjermani.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.12.2019.